



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

Nr. 15 Prot.

Tiranë, më 11 / 10 /2018

VENDIM

Nr. 7, datë 11. 10. 2018

“PËR

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 3 DATË 4.8.2017 “PËR MIRATIMIN E
METODOLOGJISË DHE MASËS SË TARIFAVE TË SHPËRBLIMIT TË
VEPRAVE TË MBROJTURA NGA E DREJTA E AUTORIT NË SISTEMIN E
ADMINISTRIMIT KOLEKTIV” I NDRYSHUAR**

Në zbatim të nenit 156, nenit 142 e në vijim, të ligjit nr. 35, datë 31.03.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”; të pikës 4 dhe 5, të kreut II të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 35, datë 18.01.2017 “Për mënyrën e funksionimit, të organizimit dhe të shpërblimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit”; vendimit nr.2, datë 20.04.2017 “Për miratimin e rregullores të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit (KKDA)”, Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në Vendimin nr. 3 datë 4.8.2017 “Për miratimin e metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit në sistemin e administrimit kolektiv” i ndryshuar, në Republikën e Shqipërisë, sipas relacionit shpjegues, tabela 1, tabela 2, tabela 3, bashkëlidhur këtij vendimi, të cilat janë pjesë përbërëse e tij.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës dhe në Fletoren Zyrtare.
3. Ngarkohet sekretariati teknik i Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

INES MUÇOSTEPA

SEKRETAR TEKNIK

SOFJAN JAUPAJ



RELACION SHPJEGUES

Aplikimi i Metodologjisë

Tabela 1:

a. ZBATIMI I METODOLOGJISË DHE TARIFIMI TEK TELEVISIONET KOMBËTARE PA PAGESË (NË VIJIM OSHMA)

Kolona (1)

Këtu janë listuar të gjitha programet e një OSHMA-je, të kategorizuara sipas përmbajtjes së tyre, psh: *programe sportive, argetuese, informative, etj.*

Kolona (2)

Në këtë kolonë janë të ardhurat Bruto që i takojnë secilit program. Këtu janë përfshirë të gjitha të ardhurat, pa zbritur zërat e listuar sipas pikës 3 të Kreu I të " Vendimit Nr.3 dt. 4.08.2017 të KKDA-së.

Shembulli është marrë duke iu referuar një subjekti që realizon të ardhura vjetore 100.000 lekë.

Kolona (3)

Pesha në përqindje që zënë të ardhurat bruto e secilit program në totalin e të ardhurave bruto vjetore të OSHMA-së.

Kolona (4) deri ne (13)

Këtu janë zbritur të gjithë zërat e listuar sipas pikës 3 të Kreu I të Vendimit nr.3 datë 4.08.2017 të KKDA-së. Shembulli është marrë duke iu referuar një subjekti që ka të ardhura nga shitja e të drejtës së transmetimit të kanalit 150.000 lekë në vit dhe të ardhura nga interneti/ rrjetet sociale 40.000 lekë në vit.

Por, sikundër mund të vërehet nga kjo tabelë, vetëm dy nga zërat e listuara sipas pikës 3 të Kreu I të "Vendimit nr.3 datë 4.08.2017 të KKDA-së, janë lehtësisht të identifikueshme pasi të gjithë elementet e tjera janë të kombinuara dhe nuk mund të zbriten në mënyrë të drejtpërdrejtë nga të ardhurat bruto të realizuara nga OSHMA-ja.

Kolona (14)

Të ardhurat Neto (nga shitja e hapësirës reklamuese) për secilin program, pasi janë zbritur të gjithë zërat e listuar sipas Pikës 3 të Kreu I të Vendimit nr.3 datë 4.08.2017 të KKDA-së, që lidhen me reklamën.

Kolona (15)

Pesha në përqindje që zë hapësira reklamuese brënda kohës së transmetimit të secilit program të një OSHMA-je.

Kolona (16)

Të ardhurat Neto, në vlerë monetare, të secilit program të gjeneruara vetëm nga hapësira reklamuese brenda kohëzgjatjes së transmetimit të një programi të OSHMA-së.

Kolona (17)

Kohëzgjatja në minuta e secilit program. Në këtë kolonë kohëzgjatja është shumëzuar me numrin e herëve të ritransmetuar të programit.

Për shembull : Programi investigativ zgjat 30 minuta. Ky program ritransmetohet 3 herë gjatë 24 orëve. Kohëzgjatja në 24 orë e këtij programi është 90 minuta. Kjo vlen vetëm për programet që ritransmetohen, pasi ka programe, sic mund të jetë programi i mëngjesit, i cili nuk ritransmetohet e për këtë kategori nuk mund të aplikohet e njëjta logjikë përlllogaritje.

Kolona (18)

Numri i puntatave në vit për secilin program. Për shembull: Për një program investigativ prodhohen 207 puntata në vit.

Kolona (19)

Totali i minutave në vit. Në këtë kolonë është shumëzuar kolona (17) (*kohëzgjatja në minuta e secilit program*) me kolonën (18)(*numri i puntatave në vit*), pra kohëzgjatja në minuta e programit gjatë një viti. Ky shumëzim bëhet duke ndjekur logjikën e të ardhurave vjetore mbi të cilat, sipas Vendimit nr.3 datë 4.08.2017 të KKDA-së, do të llogaritet tarifa për S.U.A.D.A. (Sporteli Unik i përbashkët i administrimit të të drejtës së autorit).

Kolona (20)

Minutat në secilin program, ku janë përdorur vepra të mbrojtura nga e drejta e autorit. Përlllogaritja e këtij minutazhi është bërë si më poshtë vijon:

Programi investigativ e ka kohëzgjatjen 30 minuta për puntatë. Gjatë kësaj hapësire kohore, transmetohen 2 vepra të llojit balet. Kohëzgjatja e tyre është 2 minuta për secilën performancë të llojit balet, në total 4 minuta. Ky minutazh, prej 4 minutash, përfshin pervec këngës së transmetuar, edhe elementë të tjerë të të drejtës së autorit , sic janë: koreografia, kostumografia, grimi, të cilat mbulohen nga vetë shoqëria si punëmarrës të saj (të përjashtuara sipas paragrafit (c) të Pikës 3 të Kreu I të Vendimit nr.3 datë 4.08.2017 të KKDA-së.). Pra, duke qënë se një pjesë e konsiderueshme e elementeve të një veprë zotërohen nga vetë OSHMA (si rezultat i kalimit të tyre për shkak të marrëdhënies së punësimit), atëherë nga OSHMA-ja mbetet për t'u mbuluar/paguar vetëm pjesa e përdorimit të të drejtave që nuk janë në zotërim të OSHMA-së. OSHMA në përlllogaritjen e këtij detyrimi financiar ka ndjekur logjikën sipas të cilës JO i gjithë minutazhi i sipërcituar është për t'u paguar/mbuluar financiarisht nga OSHMA-ja pranë S.U.A.D.A-s. Për shkak të arsyeve të sipërcituara është vlerësuar ky minutazh për të cilin do të përcaktohet detyrimi financiar për të shlyer nga

OSHMA-ja, do të ndahet 50 me 50 përqind. Si rrjedhim, llogaritja bëhet duke shumëzuar 4 minuta me 50% të përdorimit.

Pra në total, në një puntatë të programit investigativ kemi 2 minuta me të drejta autorësie të pakontraktuara ndaj dhe vetëm për këtë pjesë do të ekzistojë detyrimi i OSHMA për të paguar kundrejt S.U.A.D.A.

Programi muzikor e ka kohëzgjatjen 100 minuta për puntatë. Gjatë kësaj hapësire kohore, transmetohen 15 minuta muzikë për të cilën do paguhet të drejta në territor. Në këtë minutazh nuk ka kombinim të elementeve të ndryshme të veprave që mbrohen nga e drejta e autorit.

Filmat artistik/Telenovelat/Serialet. Të treja keto vepra janë të ndara sipas tabelës së mëposhtme, e cila është ndërtuar duke ndjekur logjikën e nenit 138/3 të Ligjit nr. 35/2016 "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to":

Tabela 2

Autoret	40%	Skenar	10%
		Regji	10%
		Kompozim	10%
		Muzike	10%
Interpretues	30%		
Producent	30%		

Pra, duke qënë se për Interpretuesit dhe Producentët dhe përqindjen përkatëse të autorsisë, OSHMA-ja ka paguar mbajtësin e ligjshëm të të drejtës së autorit /Subjektin licenses jashtë territorit, mbetet për tu paguar vetëm 10 % që përfshin Muzikën në territor, element ky i të drejtës së autorit, që sipas kontratave respektive mbetet për tu paguar/shlyer në territor. Por, edhe ky 10% nuk mund të jetë i plotë, kjo sepse muzika nuk zgjat gjatë gjithë kohëzgjatjes së Filmit/Telenovelës/Serialit, sikundër mund të kenë shtrirje elementë të tjerë si skenari, regjia e kompozimi, por, muzika ka një kohëzgjatje shumë të reduktuar krahasuar me elementët e tjerë e që mund të përllogaritet psh deri në 15 minuta në një film me kohëzgjatje mesatarisht 90 minuta. Për efekt llogaritjeje të detyrimit për përdorimin e veprës së mbrojtur nga e drejta e autorit, përdoret vetëm 3% të kohëzgjatjes së veprës.

Talk Show të shoqëruar nga orkestra dhe këngëtari. Gjatë kohëzgjatjes së një Talk Shoë transmetohen këngë të interpretuara nga vetë orkestra dhe këngëtari i programit, pjesë e stafit të OSHMA-së sipas marrëdhënieve të punësimit. Një vepër muzikore është e përbërë nga 4 elementë si më poshtë – Tabela 2/1:

Teksti	25%
Interpretimi	25%
Produksioni	25%
Kompozimi	25%

Gjatë interpretimit nga orkestra dhe këngëtari konsumohen 3 nga elementët e mësipërm, konkretisht : Teksti, Produksioni dhe Kompozimi. Në këto kushte vlerësohet që për këtë rast për efekt përlllogaritjeje përdoret 75% të kohëzgjatjes së veprës.

Kolona (21)

Numri i puntatave në vit për secilin program. Për shembull : Për programin investigativ prodhohen 207 puntata ne vit

Kolona (22)

Totali i minutave në vit. Në këtë kolonë është shumëzuar kolona (20) me kolonën (21), pra kohëzgjatja në minuta e përdorimit të veprave të mbrojtura gjatë një viti. Ky shumëzim bëhet duke ndjekur llogjikën e të ardhurave vjetore mbi të cilat, sipas " Vendimit Nr.3" dt.4.08.2017 të KKDA, do të llogaritet tarifa për S.U.A.D.A.

Kolona (23)

Kjo kolone llogarit, peshën në përqindje që zënë minutat me përdorim të veprave të mbrojtura gjatë një viti , në raport me minutat totale të po atij programi gjatë një viti.

Kolona (24)

Në këtë kolonë bëhet llogaritja në vlerë e të ardhurave vjetore NETO për secilin program (sipas kolonës (16) , shumëzuar me peshën që zënë minutat me përdorim të drejtash. Kjo do të thotë që nëse në programin investigativ 17% e kohës së transmetimit zihet nga veprat e mbrojtura, po kaq përqind do të zënë të ardhurat që gjenerohen nga përdorimi i këtyre veprave të mbrojtura. Pra, për programin investigativ nga **31,185** Lekë të ardhura NETO vjetore vetëm **5,198** Leke (**17%**) janë të ardhura neto të gjeneruara si rezultat i përdorimit të veprave të mbrojtura.

Tabela 3 bashkëlidhur:

b. Shembull 2. Zbatimi i metodologjisë së tarifës për televizionet/platformat me pagesë (në vijim OSHMA).

Duke ju referuar tabelës 3, për të zbatuar këto tarifa në këto lloj përdoruesish të vepra të mbrojtura duhet të përcaktojmë sa është koha e përdorimit të veprave të mbrojtura që duhet të paguhet në territor gjatë programacionit ditor dhe pesha të zënë këto vepra në të ardhurat e krijuara. Nëse një Televizion/Platforme (në vijim referuar OSHMA) ka të ardhura vjetore 1.000.000 lekë në vit aplikohet si vijon:

Nga e ardhura bruto vjetore 1.000.000 lekë zbriten të gjitha perjashtimet e cituara në përkufizimin e të ardhurës bruto si në tabelën 3:

Për sa i takon, të ardhurave nga **reklammat** në këtë lloj OSHMA, ato ndahen si vijon:

Reklama që lidhet me një vepër të prodhuar nga vetë OSHMA ose me një vepër për të cilën të drejtat e autorit janë paguar direkt tek Mbajtësi i së drejtës. Këto të ardhura janë të përjashtuara nga e ardhura bruto.

Reklama që transmetohen mes dy programeve (psh: një film dhe një emision i prodhuar nga vetë OSHMA). Në këtë rast nëse për filmin paguhen vetëm të drejtat muzikore në territor, e ardhura nga reklama duhet të konsiderohet në % me kohën që zë muzika në film. Referuar mënyrës se si ligji ka ndarë të ardhurat që do mblidhen nga sporteli i përbashkët një ndarje mund të ishte:

Autoret	40%	Skenar	10%
		Regji	10%
		Kompozim	10%
		Muzike	10%
Interpretues	30%		
Producent	30%		

Pra, 10 % e të ardhurave nga reklama që transmetohet para ose pas filmit konsiderohet si e ardhur nga vepra e mbrojtur.

Nëse një reklamë transmetohet gjatë një veprë të mbrojtur psh në një kanal muzikor të drejtat e muzikës së të cilit paguhen 100 % në territor, e ardhura nga reklama në këtë kanal është 100 % e ardhur për tu paguar për të drejtat e autorit. Nëse në këtë kanal 50 % e kohës ditore është e paguar edhe e ardhura do tarifohet me 50 %.

Të ardhurat nga abonimet:

Nëse një OSHMA me pagesë shet paketa abonimi, për programet e saj, nga e ardhura bruto që përfitohet nga këto paketa bëhet ndarja si vijon:

Nga e ardhura e plotë për abonimet zbritet në total e ardhura nga shitja e paketës sportive. Mqs kjo e ardhur nuk përcaktohet atëherë zbriten në tërësi kostot që përdoren për këtë paketë.

Nëse këto kosto përbëjnë 60 % të paketës së plotë atëherë e ardhura bruto do të mbetet 40 % e saj.

Meqënëse, në këto të ardhura përfshihen dhe të ardhura që përfitohen programe të prodhuara vetë ose programe për të cilat të drejtat e autorit dhe të drejtat lidhura me to janë paguar direkt nga OSHMA dhe kjo pjesë duhet të zbritet nga e ardhura

bruto. Por zbritja e kësaj të ardhure është e pamunduar, në këto kushte, zbresim kostot e përdorura për blerjen e veprave të mbrojtura ose në shërbim të tyre.

Nga shembulli i marrë në konsideratë më lart, përqindja që zë kostoja për këto lloj veprash është 8 %. Në këto kushte, kjo vlerë zbritet dhe vlera që do të paguaj një OSHMA në tërësi për të ardhurat sipas pikave a) dhe b) në shembull paraqitet në Tabelën 3.

****Të gjitha vlerat e përmendura në këtë relacion shpjegues janë marrë mbi baza shëmbujsh.***

Tabela 1

Te ardhurat Bruto 2016	Pesha ne %	Zbritje sipas pikes (a)	Zbritje sipas pikes (b)	Zbritje sipas pikes (c)	Zbritje sipas pikes (c)	Zbritje sipas pikes (d)	Zbritje sipas pikes (e)	Zbritje sipas pikes (e)	Zbritje sipas pikes (f)	Zbritje sipas pikes (g)	Te ardhurat BRUTO per ardhurane programet që shfrytëzojnë	Koeficienti i ardhurave brenda programit	Te ardhurat ne vlerë sipas koeficientit	Kohëzgjatja e min	Puntatja ne vit	Totali i min ne vit	Mja me perdorim te drejtyre te autorit	Puntatja ne vit	Totali i min me te perdorim te drejtyre te autorit ne vit	Pesha ne % e min te perdorura/total min te programit ne vit	Te ardhurat bruto bazuar ne min e perdorura	
2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24
59,500	6%							7%	(2,800)		56,700	55%	31,185	90	207	18,630	6	207	1,242	7%	2,079	
8,500	1%							1%	(400)		8,100	60%	4,860	230	101	23,230	78	101	7,878	34%	1,648	
51,000	5%							6%	(2,400)		48,600	70%	34,020	110	28	3,080	10	28	280	9%	3,093	
127,500	13%					(127,500)		13%	(6,000)													
4,250	0%							1%	(200)		4,050	100%	4,050	11	365	3,833	2	365	730	19%	771	
17,000	2%							2%	(800)		16,200	42%	6,804	50	45	2,250	40	45	1,800	80%	5,443	
25,500	3%							3%	(1,200)		24,300	42%	10,206	60	42	2,520	30	42	1,260	50%	5,103	
25,500	3%							3%	(1,200)		24,300	83%	20,169	133	130	17,290	4	130	520	3%	607	
34,000	3%							4%	(1,600)		32,400	80%	25,920	195	25	4,875	45	25	1,125	23%	5,982	
29,750	3%							4%	(1,400)		28,350	66%	18,711	100	223	22,300	27	223	6,021	27%	5,052	
34,000	3%					(34,000)		4%	(1,600)													
102,000	10%					(102,000)		12%	(4,800)													
25,500	3%							3%	(1,200)		24,300	62%	14,945	100	211	21,100	60	211	12,660	60%	8,967	
17,000	2%							2%	(800)		16,200	100%	16,200	45	12	540	1	12	16	3%	486	
25,500	3%							3%	(1,200)		24,300	100%	24,300	62	30	1,860	2	30	56	3%	729	
25,500	3%							3%	(1,200)		24,300	100%	24,300	120	62	7,440	4	62	223	3%	729	
68,000	7%					(68,000)		8%	(3,200)													
21,250	2%							3%	(1,000)		20,250	55%	11,138	80	40	3,200	7	40	280	9%	975	
21,250	2%							3%	(1,000)		20,250	68%	13,770	140	211	29,540	9	211	1,899	6%	885	
85,000	9%					(85,000)		10%	(4,000)													
17,000	2%							10%	(800)		16,200	77%	12,474	130	213	27,690	40	213	8,520	31%	3,838	
8,500	1%							2%	(400)		8,100	69%	5,589	90	24	2,160	20	24	480	22%	1,242	
8,500	1%							1%	(400)		8,100	72%	5,832	45	20	900	2	20	40	4%	259	

TABELA NR. 2

Autoret	40%	Skenar	10%
		Regji	10%
		Kompozim	10%
		Muzike	10%
Interpretues	30%		
Producent	30%		

Tabela 3

OSHMA PAY TV- SHEMBULL MARZHI BRUTOR

MARZHI BRUTO (shifrat ne ALL)	VITI 2017	%
TE ARDHURA		
ABONIME TE PLATFORMES DIGITAL	525,355	53%
DISTRIBUCIONI I TE DREJTAVE	332,345	33%
MALLRA	69,446	7%
REKLAMA	26,149	3%
TE DREJTA TV	12,970	1%
TE TJERA qe nuk lidhen me aktivitetin	33,734	3%
TOTAL	1,000,000	100%
SHPENZIME		
MALLRA	82,875	11%
BLERJE PER PROGRAMACION	516,769	69%
KOSTO TRANSMETIMI	126,727	17%
KOSTO TE TJERA DIREKTE TE TRAN	23,629	3%
		0%
		0%
		0%
TOTAL	750,000	100%
FITIMI BRUTO	250,000	
<i>Marzhi bruto ne %</i>	<i>25%</i>	
SHPENZIME PER PROGRAMACIONIN (	VITI 2017	%
BLERJE PER PROGRAMACION	516,769	100%
1 Te drejta TV (filma, seriale, telenovela, e	41,342	8.0%
2 Kanale TV (kombetare dhe nderkombeta	105,938	20.5%
3 Te drejta TV sportive	263,552	51.0%
4 Kosto teknike per te drejtat sportive	29,973	5.8%
5 Perpunim (perkthim, lexim, titrim)	25,838	5.0%
6 Produksione	50,106	9.7%

OSHMA PAY TV -SHEMBULL - TABELA 3**Shembull per llogaritjen e tarifes**

E ardhura bruto (shifrat ne ALL)	1,000,000
a) zbritur te ardhurat nga shitje malli dhe produkte	69,446
b.1) zbritur reklama ne eventet sportive	1,814
b.2) zbritur reklama per prodhime te veta	544
d.1) zbritur te ardhura nga shitja e eventeve sportive	126,085
dh.1) zbritur te ardhura nga distribucioni i te drejtave	332,355
dh.2) zbritur te ardhurat nga shitja e te drejtave TV	12,970
e-g) zbritur te ardhura te tjera	33,734
E ardhura neto*	423,051

d) *Te ardhurat e eventeve sportive vleresohen 57 % e te ardhurave te abonimeve, sa raporti i kostove te sportit ndaj total kostove te programacionit*

Kosto e vepres se mbrojtur ne raport me total shpenzimet e programacionit eshte 8%

E ardhura e tarifueshme = e ardhura neto* X 8 % 33,844

Tarifa = 1% x e ardhura e tarifueshme 338